



Planuar / Dorezuar Prijemto/Prodato Received / Delivery	27. 01 2022	viti god year	2
Organ /Njësia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMST/OC	384/2022		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1109/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Eshref Shabani dhe Jeton Kocanëtarë, me Valentina Kaçandolli Bekteshi-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1109/2021 të datës 13.12.2021 të parashtruar nga ankuesja me adresë

kundër organit të punësimit/Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike „kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 26.01.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1109/2021 e datës 13.12.2021, e parashtruar nga ankuesja.

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër të protokollit 10/2021 i datës 30.11.2021 i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë/Ministria e Punëve të Brendshme.

A r s y e t i m

Ankuesja me datë 13.12.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër të protokollit 10/2021 të datës 30.11.2021 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë/Ministria e Punëve të Brendshme, pasi që ankuesja nuk ka hyrë në listë të ngushtë në procesin e rekrutimit për vendin e punës “Drejtor i Përgjithshëm” në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërtimtarisë dhe Tregtisë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 21.12.2021 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankese në Ministrinë e Punëve të

Brendshme. Ndërsa me datë 21.01.2022 Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën e ankueses së datës 13.12.2021 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me nr.prot 10/2021 të datës 31.11.2021 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë; Vendimi i datës 31.03.2010 për ndërrimin e vendit të punës; Udhëzimi Administrativ Nr.2008/2 për Organizimin e Veprimtarisë dhe Strukturimin e Brendshëm të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë; Akt emërimi i datës 02.08.2021; Vendimi për emërimi i datës 30.07.2021; Vendimi për emërim i datës 15.05.2018; Akt emërimi i datës 08.10.2012; Përshkrimi i detyrave të punës; Konkursi i datës 30.10.2021; Vendimi me nr.prot.30/2021 i datës 25.11.2021; Njoftimi i datës 25.11.2021; e-mail i datës 19.01.2022; Lista e aplikantëve; Aplikacioni i ankueses; Shtojca Rregullat e Mirësjelljes së Shërbimit Civil; Çertifikatë nga evidenca personale; Letër motivi i ankueses; Formulari për objektivat vjetore janar-dhjetor 2020; janar-dhjetor 2019; Vlersimi i përgjithshëm mbi performancën për vitin 31.12.2019 për vitin 31.12.2020; Certifikata e lëshuar nga World Bank Group 2021, 2020; e-mail i datës 12.11.2021; Diploma e Fakultetit e ankueses; Diploma e masterit; Kontrata e marrëdhënies së punës me numër 790/08; Vendimi për ndërrimin e vendit të punës i datës 31.03.2010; Vërtetimi i punës nga "KLUZ"; Vërtetim i datës 11.11.2021 si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, konstatoi se ankesa e ankueses është e pabazuar *sepse*:

Sipas shkresave të lëndës Kolegji ka gjetur se Ministria e Punëve të Brendshme, me datë 30.10.2021 ka shpallur konkursin me numër reference RN00007682 për vendin e punës "Drejtor i Përgjithshëm (2)" në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësis dhe Tregtisë.

Ankuesja, për këtë pozitë të punës, me datë 12.11.2021 ka bërë aplikimin me numër aplikacioni RN00007682. Ndërsa, me datë 25.11.2021 me numër të protokollit 30/2021 Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë/Ministria e Punëve të Brendshme, në fazën e verifikimit të dokumentacionit, ka nxjerr Vendim për refuzimin e aplikacionit të ankueses me numër RN00007682, mbi bazë se ankuesja nuk ka ofruar dëshmi për përvojën e punës menagjeriale së paku pesë (5) vite ashtu siç është kërkuar me konkurs.

E pakënaqur me vendimin mbi refuzimin e aplikacionit, ankuesja me datë 26.11.2021 ka parashtruar ankesë në mënyrë elektronike kundër Vendimit me numër të protokollit 30/2021 të datës 25.11.2021. Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë me datë 30.11.2021 merr vendimin me numër të protokollit 10/2021 me të cilin vendim refuzohet si e pa bazuar ankesa e parashtruar nga ankuesja.

Kundër Vendimit të datës 30.11.2021 me numër të protokollit 10/2021, të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, ankuesja brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të: "konstatimit të



gabuar të gjendjes faktike, zbatim të gabuar të së drejtës materiale lidhur me aplikimit të kritereve në konkursin publik për pozitën Drejtor i Përgjithshëm në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës-MTI".

Sipas Konkursit me numër reference RN00007682 i shpallur me datë 30.10.2021, për "Drejtor i Përgjithshëm (2)" në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësis dhe Tregtisë, si kërkesa të përgjithshme formale janë përcaktuar si vijon:

- *Arsimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve universitare me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to në fushat: diplomë universitare në menaxhment, administrim biznesi, biznes ndërkombëtar, ekonomik ose juridik;*
- *Përvoja e punës e kërkuar: Së paku tetë (8) vite përvojë pune profesionale, duke përfshirë së paku pesë (5) vit përvojë pune në pozitën drejtuese.*

Lidhur me shqyrtimin e pretendimit ankimor të ankueses se i njëjti ka poseduar përvojën e punës për pozitën në fjalë, Kolegji nga analizimi i dosjes se aplikimit të ankueses ka gjetur se ankuesja sipas Diplomës të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", ka përfunduar studimet me datë 15.01.2001 duke marrë titullin Ekonomist i Diplomuar, dhe si rrjedhojë Kolegji konstaton se ankuesja nuk ka përmbushur kërkesat e Konkursit me numër reference RN00007682, përkatësisht nuk ka ofruar dëshmi pranë organit të punësimit për përvojën e punës menagjeriale së paku pesë (5) vite ashtu siç është kërkuar me konkurs, kështu që pretendimi ankimor në këtë kuptim është i pa bazuar.

Po ashtu Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankueses e cila pretendon se sa ka qenë në vendin e punës në pozitën "Zyrtare e Lartë e Zhvillimit të Ndërtimitarisë në MTI", kjo pozitë sipas Udhëzimit Administrativ Nr.2008/2 ka qenë pozitë menaxheriale, Kolegji ka konstatuar se sipas Udhëzimit Administrativ Nr.2008/2 për Organizimin e Veprimtarisë dhe Strukturimin e Brendshëm të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë pozita "Zyrtar i Lartë për Zhvillimin e Ndërtimitarisë", tek detyrat dhe përgjegjësit nuk ka përcaktuar se kjo është pozitë udhëheqëse por në mënyrë taksative ka përcaktuar se:

- *Detyrat dhe përgjegjësitë janë:*
- *Organizon dhe propozon masa konkrete për avancimin e industrisë ndërtimore në fushën e licencave dhe rregullave të avancuara që aplikohen në rajon dhe BE;*
- *Identifikon fushat e prioriteteve, ndihmon bashkëpunimin e subjekteve dhe institucioneve të tjera;*
- *Merr pjesë në hartimin e programeve zhvillimore të industrisë ndërtimore;*
- *Bashkëpunon me institucionet e tjera në harmonizimin e rregullave tekniko-teknologjike në fushën e industrisë ndërtimore;*
- *Propozon masa konkrete në avancimin e punës në divizion;*
- *Ofron ndihmë profesionale për avancimin e standardeve teknike dhe rregullave teknike;*
- *Përcjell dhe merr pjesë në avancimin e zhvillimit të industrisë ndërtimore;*
- *Kryen detyra shtesë sipas kërkesës së eprorit.*

Andaj, duke marr parasysh konstatimin si më lartë, Kolegji vlerëson se Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë me rastin e nxjerrjes së Vendimit të datës 25.11.2021 me numër të protokollit 30/2021 me të cilit ka refuzuar aplikacionin e ankueses për shkak të se



nuk ka ofruar dëshmi për përvojën e punës menagjeriale së paku pesë (5) vite ashtu siç është kërkuar me konkurs dhe Vendimit të datës 30.11.2021 me numër të protokollit 10/2021 për refuzimin e ankesës të datës 26.11.2021, ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar ligjin material, duke vepruar kështu në përputhje me nenin 15 paragrafi 1, 2, dhe 5 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se: 1.Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidati plotëson kushtet për aplikim 2. Verifikimi paraprak kryhet nga Njësia Përgjegjëse, në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikimit dhe verifikimeve të tjera sipas detyrës zyrtare që ndërlidhen me verifikimin paraprak. 5.Kandidatë, që nuk plotësojnë kushtet për aplikim në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, nuk kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurrimin.. ndërlidhur me nenin 34 paragrafi 6 nen paragrafi 6.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrat e Publikë.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi është i paligjshëm, mund të inicioj konflikt administrativ në gjykatën kompetente,/Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën ka pranuar vendimin. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1109/2021, datë 26/01/2022

Valentina Kaçandoll BEKTESHI

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- ❖ Ankueses
- ❖ Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- ❖ Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së

